



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

REKTORATI

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN University of Prizren Universiteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 23.06.2017	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-148-A

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Rektor - Prof. dr. Ramë Vataj

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, në bazë të dispozitave ligjore të nenit 38, 39, 40 dhe 41 të Statutit të Universitetit Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013 dhe Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës si dhe të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, pas njoftimit zyrtar për anulim të konkursit nr. 01-111, rishpall:

## KONKURS

për:

Titulli i vendit të punës: **Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit, (1) UNI6 (SP/020).**

Mbikëqyrësi i nëpunësit: **Rektori i Universitetit.**

Pozita: **Shërbyes Civil i karrierës -Niveli i Lartë Drejtues, orari i plotë (40 orë në javë).**

Vendi i punës: **Prizren, Republika e Kosovës.**

Kandidatët që konkurrojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-149, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Të kenë diplomë universitare me më së paku katër (4) vjet të studimeve;
- Duhet të jenë nga fusha profesionale e drejtësisë,
- Të kenë tetë (8) vjet përvojë pune, prej tyre 5 vite menaxheriale ;
- Të kenë aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese;
- Të kenë njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit të lartë.

**Detyrat-Përgjegjësitë:** nën mbikëqyrjen e Rektorit kryen ushtron këto detyra:

- Është zyrtar më i lartë i administratës;
- Është udhëheqës i administratës qendrore;
- Është udhëheqës i Sekretarëve të Njësive Akademike;
- Është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efikase, ekonomike dhe efektive të Universitetit;
- Është udhëheqës i drejtorëve të departamenteve në kuadër të administratës qendrore;
- Është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor;
- Është përgjegjës për çështje të tjera që kërkohen nga Këshilli Drejtues dhe Rektori, të cilat nuk janë të përcaktuara me Statut.

**Paraqitja e kërkesave:**

Aplikacionet merren në Rektorat, zyra nr. 308, adresa: rruga "Shkronjave" nr. 1, Prizren ose mund t'i shkarkoni nëpërmjet adresës elektronike në linkun: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com).  
Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Rektoratit. Aplikacioni i kompletuar duhet të dorëzohet edhe në formën elektronike në adresën [apliko.upz@uni-prizren.com](mailto:apliko.upz@uni-prizren.com).

***Dokumentacioni për aplikim:***

- Fletë aplikacionin dhe CV-në
- Letërnjoftimin fotokopje,
- Ekstraktin e lindjes, origjinale,
- Diploma Universitare, (të diplomuarit në universitet jashtë Republikës së Kosovës t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës), të noterizuar,
- Dëshminë për përvojën e punës profesionale dhe menaxheriale (origjinale ose të noterizuar) dhe dëshminë e përvojës së punës në përgjithësi duke i bashkangjitur edhe pasqyrën e Trustit.
- Dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për vepër penale dhe
- Dokumentacionet shtesë sipas vlerësimit të kandidatëve të rëndësishme për pozitën që aplikon.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas përfundimit të afatit për aplikim nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjete (15), ditë nga dita e shpalljes në gazetë përkatësisht deri më: 07.07.2017.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adrese elektronike: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com), ku edhe mund ta shkarkoni aplikacionin zyrtar.